

Hapet thirrja për bursa studimi për studentët e UMT, në Universitetin Lodz në Poloni, në kuadër të programit Erasmus +.

Mobiliteti dhe kohëzgjatja e bursave:

Studentët do të studiojnë semestrin e dytë të vitit akademik 2024-2025 në Universitetin Lodz në Poloni.

Kush mund të aplikojë:

Mund të aplikojnë studentët e UMT të cilët gjatë vitit akademik 2024-2025 do të jenë në vitin e dytë, të ciklit bachelor si edhe studentët e vitit të parë të master, në:

- Fakultetin e Ekonomisë
- Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe IT;

****Studentët që janë gjatë semestrit të fundit të studimit nuk mund të aplikojnë.*

Lëndët të cilat zhvillohen në anglisht në universitetin pritës në semestrin e dytë i gjeni duke klikuar në linkun <https://www.uni.lodz.pl/en/mobility-study-programmes-and-courses>

Gjuha e mësimdhënies:

Mësimdhënia do të jetë në gjuhën angleze.

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (800 EUR në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- Forma e Aplikimit (word dhe pdf.)
- Vërtetim dhe Listë notash e ciklit aktual të studimit;
- Kopje e pasaportës;
- Fotokopje e Certifikatës/dëshmi e gjuhës angleze ose dokument që vërteton njohuritë në këtë gjuhë. Niveli i kërkuar B2;
- Letër Motivimi;
- Dokumenti Preliminary Learning Agreement;
- Kopje e skanuar e certifikatës së fundit të shkollës/arsimimit ose diplomës së marrë;

* *Learning Agreement* është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin Metropolitan Tirana kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Lodz, Poloni lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë të vitit akademik 2024/2025 në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të jepni provim lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Metropolitan Tirana.

Dokumenti “*Learning Agreement*” tek seksioni “*Commitment*” firmoset nga aplikanti dhe mëpas në seksionin “*sending university*” firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit në UMT

*****Për të marrë të gjitha dokumentet e nevojshme në lidhje me aplikimin tuaj, ju lutemi kontaktoni Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë nëpërmjet e-mailit iro-projects@umt.edu.al**

Afati për aplikim: 27 Nentor, 2024

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentet të skanuara me e-mail në adresën iro-projects@umt.edu.al ose dorazi në Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë në Universitetin Metropolitan Tirana.

UMT ju uron shumë suksese në aplikimin tuaj!